

# KULETAT E SUBJEKTEVE POLITIKE PARLAMENTARE 2.0

DHJETOR, 2023







Instituti Demokratik I Kosovës është degë e  
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e  
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse  
dhe luftës kundër korrupsion përmes  
promovimit të transparencës,  
llogaridhënies dhe integritetit në të  
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2023. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239

10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Autor: Eugen Cakolli

Layout and design: **envinion**

**Sqarim:** Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Çeke në kuadër të Programit për Promovimin e Tranzicionit të implementuar në bashkëpunim me Transparency International Czech Republic ([www.transparency.cz](http://www.transparency.cz)). Opinionet, gjetjet dhe rekomandimet në këtë raport janë përgjegjësi ekskluzive e KDI-së, ndaj nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

**06**

HYRJE

**07**

ÇKA THONË RAPORTET E AUDIMIT  
TË FINANCEVE TË SUBJEKTEVE  
POLITIKE?

**08**

SA KANË DEKLARUAR TË HYRA  
SUBJEKTET POLITIKE?

**09**

SA SHPENZUAN SUBJEKTET  
POLITIKE NË VIT JOZGJEDHOR?

Pagesat mbi 5 mijë euro

**11**

DONACIONET PËR SUBJEKTET  
POLITIKE

**12**

BUXHETIMI GJINOR



# HYRJE

Në shtator të vitit 2022, ka hyrë në fuqi ligji i ri mbi financimin e subjekteve politike në Kosovë. Ky ligj ka shënuar progres në raport transparencën dhe llogaridhënien financiare të subjekteve politike. Megjithatë, legjislacioni ende përmban mangësi dhe probleme sa i përket sanksioneve në rast të shkeljeve, për shkak të gjobave të ulëta. Të parregulluara në tërësi kanë mbetur çështja e (vetë)financimit të kandidatëve, fushatat online dhe fushata nga palët e treta.

Për më tepër, nuk është konsoliduar në tërësi kuadri sekondar ligjor, duke përfshirë rregulloret e brendshme të Zyrës dhe KQZ-së mbi kontrollin financiar, si dhe aktet tjera që është paraparë të nxirren nga Ministria e Financave.

Ndërsa, në praktikë, Zyra ende vijon të jetë pa resurset e nevojshme për ushtrimin e kontrollit adekuat financiar, në mungesë të stafit të nevojshëm – duke qenë se ende të angazhuar janë vetëm tre persona si staf, ndërsa ligji i parasheh të paktën 10 të tillë.

Raportet e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve politike për vitin 2022 janë publikuar nga ana e KQZ-së në fund të muajit nëntor të vitit 2023. Paraprakisht, raportet e paaudituar ishin publikuar qysh në prill të vitit 2023.

Auditimi i raporteve vjetore financiare është kryer nga Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, e cila ka përzgjedhur një operator për kryerjen e auditimit.



Në mesin e  
**52**  
subjekteve politike



raportet vjetore  
të së cilave  
janë audituara,

**24**

kanë marrë opinion  
të përmbajtur,

**17**

opinion të  
pakualifikuar,

**7**

opinion të  
kualifikuar,

**4**

të tjera mohim  
opinionit.

# ÇKA THONË RAPORTET E AUDIMIT TË FINANCAVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE?

Sikur çdo vit, subjektet politike parlamentare gjatë vitit 2022 kanë marrë plot 4 milion e 200 mijë euro nga buxheti publik, të cilat ndahen proporcionalisht me numrin e ulëseve në Kuvend.

Auditorët e angazhuar nga KQZ-ja kanë pasur përgjegjësi për auditimin e raporteve vjetore financiare të 52 subjekteve politike të regjistruara pranë KQZ-së. Prej tyre, 14 janë raporte vjetore të partive politike parlamentare – që janë përfituese të mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve politike – të cilat përgjithësisht kanë marrë vlerësime pozitive nga ana e auditorëve.

Në mesin e subjekteve politike parlamentare, katër subjekte kanë marrë opinione të pakualifikuara, xx të kualifikuara, xx opinion të përmbajtur si dhe një subjekt politik mohim të opinionit.

Opinione të pakualifikuara kanë marrë Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Jedinstvena Goranska Partia (JGP), Koalicioni VAKAT (VAKAT), Socialdemokratska Unija (SDU), Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), Nova Demokratska Stranka (NDS), dhe Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me raportet e auditimit që vlerësojnë se pasqyrat financiar dhe dokumentet tjera janë të gjitha në përputhje me ligjin.

Në kuadër të subjekteve politike parlamentare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Srpska Lista (SL), dhe Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), kanë marrë opinion të kualifikuar, meqenëse raportet e tyre kanë përmbajtur probleme, veçanërisht sa i përket qirave dhe xhirollogarive bankare.

Partia Demokratike e Kosovës ka marrë opinion të kualifikuar, mbi bazën e mungesës së të dhënave financiare dhe kontratave mbi qiratë që ka kjo parti në tërë vendin. Po ashtu, kjo parti ende i ka aktive tri xhirollogari bankare në banka të ndryshme (ndonëse nuk ka pasur transaksione financiare nga to), edhe pse ligji e përcakton qartazi që duhet të ketë një xhirollogari të vetme.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka marrë po ashtu opinion të kualifikuar, për shkak të problemeve të evidentuara nga auditorët lidhur me llogaritë e pagueshme (në vlerë 75 mijë euro), mosprezantimit të kontratave lidhur me selinë qendrore në Prishtinë, si dhe ekzistimit të një xhirollogarie të dytë bankare (ndonëse është dërguar kërkesa për mbyllje).

Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, opinionin i kualifikuar evidenton probleme me prezantimin e qirave të zyrave, duke theksuar që ndonëse AAK-ja ka deklaruar formalisht 10 degë në nivel vendi, ka prezantuar të dhëna për qiratë e zyrës vetëm për selinën qendrore në Prishtinë.

Në opinionin e kualifikuar për Listën Serbe, raporti i auditimit thekson mungesën e politikave të brendshme financiare për drejtim dhe kontroll financiar, si dhe mosrespektimit të procedurave të prokurimit për shpenzimet buxhetore.

Partia GUXO, është subjekti i vetëm politik i përfaqësuar në Kuvend, që ka marrë opinion të përmbajtur, mbi bazën e raportimit të zero aktiviteteve financiare përgjatë vitit 2022. Ndërsa, Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) ka marrë mohim të opinionit, për shkak të mungesës së informacioneve, mosbashkëpunimit dhe raportimit jo të drejtë të të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2022.



# SA KANË DEKLARUAR TË HYRA SUBJEKTET POLITIKE?


Subjektet politike parlamentare përfitojnë nga financimi publik 4,2 milionë euro çdo vit. Këto mjete ndahen përmes Fondit për mbështetjen e subjekteve politike – 3,8 milion euro ndahen për subjektet politike ndërsa 400 mijë euro për grupet përkatëse parlamentare.

Në këtë legjislaturë janë gjithsej 15 subjekte politike parlamentare, të cilat përfitojnë nga Fondi. Lëvizja Vetëvendosje, si subjekti më i madh parlamentar, përfiton çdo vit 2 milionë euro, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës që përfiton 665 mijë euro, Lidhja Demokratike e Kosovës 525 mijë euro, Lista Serbe 315 mijë euro, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 280 mijë euro, Partia Demokratike Turke e Kosovës 70 mijë euro, si dhe subjektet tjera<sup>1</sup> me nga 35 mijë euro secila. Shumica dërrmuese e subjekteve politike kanë deklaruar suficit buxhetor.

Për vitin 2022, Lëvizja Vetëvendosje ka deklaruar se ka gjeneruar të hyra në vlerë prej 2,052,868.37 eurosh, prej të cilave 1,990,255.10 euro janë nga buxheti publik, ndërsa rreth 30 mijë euro janë donacione.

Partia Demokratike e Kosovës ka deklaruar rreth 670 mijë euro të hyra, prej të cilave 660 mijë euro janë nga buxheti publik. Ngjashëm, Lidhja Demokratike e Kosovës ka deklaruar të hyra rreth 500 mijë euro, 487 mijë prej të cilave janë nga buxheti publik.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lista Serbe, janë dy subjektet politike parlamentare, të gjitha të hyrat e të cilave janë deklaruar se vijnë nga financimi përmes buxhetit publik. AAK-ja ka deklaruar rreth 280 mijë euro të hyra për vitin 2022, ndërsa Lista Serbe rreth 350 mijë.



<sup>1</sup> G.I. za Slobodu Pravdu i Opstanak, Koalicija Vakati, Inicijativa e Re Demokratike e Kosovës, Romani Inicijativa, Nova Demokratska Stranka, Socialdemokratska Unija, Jedinstvena Goranska Partija, Partia e Ashkalinjëve për Integrim, dhe Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës.





# SA SHPENZUAN SUBJEKTET POLITIKE NË VIT JOZGJEDHOR?

Pavarësisht se viti 2022 ishte vit jozgjedhor, subjektet politike parlamentare kanë vijuar të shpenzojnë përgjithësisht njëjtë – të paktën në letër. Ajo çfarë vërehet nga raportet financiare, është që partitë politike e shpenzojnë më shumë se gjysmën e buxheteve të tyre vjetore në paga dhe kompensime. Ndërsa, pavarësisht shpenzimeve evidente në reklamim politik me pagesë, subjektet politike ende vazhdojnë të raportojnë formate shabllone, ku nuk ofrohen të dhëna të detajuara mbi reklamimin politik.

Lëvizja Vetëvendosje ka shpenzuar mbi 1,3 milion euro, prej të cilave mbi 700 mijë janë në paga dhe kompensime. Ndërsa, rreth 300 mijë euro janë shpenzuar në kategorinë e shpenzimeve të përgjithshme, ku përfshihen qiratë e lokaleve dhe zyrave. Në kategorinë e “reklamave, reprezentacionit dhe konferencave” Lëvizja Vetëvendosje ka deklaruar shpenzime prej 180 mijë eurosh.

Partia Demokratike e Kosovës ka shpenzuar rreth 610 mijë euro, prej të cilave 75% në paga dhe kompensime. Rreth 150 mijë euro janë shpenzuar reklama, reprezentacion, konferenca, shpenzime të qirave dhe shpenzime tjera.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka deklaruar shpenzime në vlerë prej 430 mijë eurosh, në kuadër të së cilave mbizotërojnë shpenzimet për paga dhe kompensime me 280 mijë euro. LDK ka deklaruar vetëm rreth 30 mijë euro shpenzime për reklama, reprezentacion dhe konferenca, ndërsa, rreth 60 mijë euro për qira të zyrave.

Nga rreth 220 mijë euro shpenzime të deklaruara nga AAK-ja, mbi 120 mijë janë dhënë për paga dhe kompensime. Pjesa tjetër është deklaruar se janë shpenzuar për shpenzime të qirasë, reklama, reprezentacion dhe konferenca, si dhe blerja e mallrave për furnizim të zyrave.

Lista Serbe ka deklaruar shpenzime prej mbi 210 mijë eurosh gjatë vitit 2022. Mirëpo, ndryshe nga subjektet tjera politike parlamentare, vetëm çereku i shpenzimeve

të Listës Serbe kanë shkuar për paga dhe kompensime, ndërsa gjysma e buxhetit – mbi 100 mijë euro – janë shpenzuar për aktivitete kulturore dhe rekreative.

## Pagesat mbi 5 mijë euro

Lëvizja Vetëvendosje është ndër subjektet e pakta politike që ka deklaruar pagesa në vlerë 5 mijë euro, me gjithsej 12 të tilla, që arrijnë vlerën totale prej mbi 110 mijë eurosh. Sipas vlerave të deklaruara, kryesisht këto pagesa janë bërë për aktivitete ditore të subjekteve politike dhe matje të opinionit publik.

Partia Demokratike e Kosovës ka raportuar gjithsej 6 pagesa në vlerë prej mbi 5 eurosh, që arrijnë vlerën prej mbi 80 mijë eurosh – ku përfshihen pagesa për marketing, këshilla juridike, hulumtime të opinionit publik, dhe të tjera.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka deklaruar vetëm dy pagesa mbi 5 mijë euro, që përfshijnë vetura me ‘leasing’, si dhe akomodim e bileta.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka deklaruar 11 pagesa në vlerë mbi 5 mijë euro, që kapin shifrën e përgjithshme prej afërisht 90 mijë eurosh. Matja e opinionit publik, pagat, obligimet për zgjedhjet e vitit 2021 dhe blerja e pajisjeve të IT-së, janë qëllimet e këtyre pagesave.

Lista Serbe ka deklaruar më së shumti pagesa mbi 5 mijë euro, me mbi 20 të tilla, që arrijnë vlerën e përgjithshme rreth 150 mijë euro. Ajo çfarë bie në sy, e që është evidentuar edhe nga gjetjet e auditimit, shumica e këtyre pagesave janë fikse prej 5 mijë eurosh për një organizatë jo-qeveritare dhe një qendre kulturore, për organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve/seminareve/konferencave.

|||||

Subjekti politik	Të hyrat	Shpenzimet
Lëvizja Vetëvendosje	€ 2,052,868.37	€ 1,310,341.74
Partia Demokratike e Kosovës	€ 674,056.36	€ 613,239.14
Lidhja Demokratike e Kosovës	€ 497,414.01	€ 431,131.82
Srpska Lista	€ 351,900.00	€ 214,048.18
Aleanca për Ardhmerine e Kosovës	€ 279,700.00	€ 219,370.78
Kosova Demokratik Turk Partisi	€ 84,306.66	€ 82,959.10
Jedinstvena Goranska Partia	€ 35,000.00	€ 26,839.14
Koalicioni Vakrat	€ 35,367.98	€ 45,812.98
Partia e Ashkalinjeve për Integrim	€ 35,000.00	€ 34,979.83
Socialdemokratska Unija	€ 38,415.45	€ 36,925.71
Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës	€ 35,000.00	€ 35,073.67
Nova Demokratska Stranka	€ 35,019.20	€ 36,583.30
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës	€ 35,431.33	€ 33,736.35
<b>TOTAL</b>	<b>€ 4,189,479.36</b>	<b>€ 3,121,041.74</b>

|||||

# DONACIONET PËR SUBJEKTET POLITIKE


Subjektet politike janë të lejuara të pranojnë donacione nga personat fizikë dhe ata juridikë, nën kufizime të përcaktuara për shumën e përgjithshme që mund të pranohet brenda një viti kalendarik. Për personat fizikë, kufizimi është 2 mijë euro brenda një viti kalendarik, ndërsa për ata juridik 10 mijë euro brenda vitit kalendarik. Në këtë kufizim përfshihen edhe kontributet në natyrë.

Sidoqoftë, subjektet politike vazhdojnë që përgjithësisht të mos i raportojnë kontributet në natyrë. Ky fenomen, bashkë me atë të donacioneve nga anëtarët e subjekteve politike, janë mjaft të shprehur në kuadër të financimit politik në Kosovë. Ndërsa, as pjesa e vetëfinancimit të kandidatëve nuk raportohet fare në pasqyrat financiare të kandidatëve.

Lëvizja Vetëvendosje është subjekti politik që ka deklaruar më së shumti donacione, përkatësisht 180 sosh, në vlerë prej rreth 30 mijë eurosh – përgjysmë më pak se në vitin paraprak. Pothuajse të gjitha donacionet e raportuara nga Lëvizja Vetëvendosje janë nga anëtarë – përfshirë deputetë, ministra apo këshilltarë komunalë – që kanë ofruar donacione në vlera të ndryshme përgjatë vitit, ndonëse Lëvizja Vetëvendosje ka deklaruar suficit prej rreth 750 mijë euro për vitin 2022.

Partia Demokratike e Kosovës ka deklaruar vetëm një donacion në vlerë prej 1 mijë euro. Njëjtë, me vetëm një donacion të deklaruar, në vlerë prej 1 mijë euro, është edhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lista Serbe nuk kanë deklaruar asnjë donacion të pranuar.

Lëvizja Vetëvendosje është i vetmi subjekt politik që ka deklaruar se ka pranuar kontribute në natyrë, ndonëse në vlerë minimale – prej rreth 5 mijë eurosh.





# BUXHETIMI GJINOR

Pavarësisht që subjektet politike parlamentare kanë pasur të hyra prej 4,2 milion euro përgjatë vitit 2022, si dhe shpenzime prej 3,1 milion euro, asnjë prej tyre nuk ka alokuar linja të veçanta për forumet apo njësitë tjera të organizimit të grave. Madje, në mungesë të detajeve mbi shpenzimet, nuk ka informacione se sa nga aktivitetet e organizuara nga subjektet politike kanë qenë aktivitete të forumeve të grave. Megjithatë, sipas deklarimeve të zyrtarëve të subjekteve politike, përveç se brenda partive mungojnë linjat e veçanta të financimit të aktiviteteve të forumeve të grave, edhe ato që organizohen janë zakonisht të bashkëfinancuara apo të organizuara nga organizata ndërkombëtare apo vendore, në formë të trajnimeve apo punëtorive për rritje të kapaciteteve.



|||||

|||||





Me përkrahjen financiare të:

**TRANSITION**